

LIGJI Nr. 03/L-203

PËR METROLOGJI

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

LIGJ PËR METROLOGJI

**Neni 1
Qëllimi**

Me këtë ligj rregullohet sistemi i njësive matëse, etalonët për matje, procedurat e vlerësimit të konformitetit të mjeteve matëse, kërkesat metrologjike për produktet e para paketuara, autorizimet në fushën e metrologjisë, mbikëqyrjen metrologjike si dhe përgjegjësitë e Departamentit të Metrologjisë.

**Neni 2
Fusha e zbatimit**

Ky ligj zbatohet në fushat që kanë të bëjnë me mbrojtjen e shëndetit të njerëzve dhe kafshëve, mbrojtjen e konsumatorit, mjedisit dhe sigurisë së përgjithshme teknike, transaksionet e mallrave dhe shërbimeve.

**Neni 3
Përkufizime**

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim:

1.1. **Ministria** - Ministria e Tregtisë dhe Industrisë.

1.2. **Ministër** - Ministrin e Ministrisë të Tregtisë dhe Industrisë.

1.3. **Metrologji** - shkenca e matjeve.

1.4. **Matje** - seria e veprimeve për përcaktimin e vlerës së një madhësie.

1.5. **Njësi matëse** - madhësia e caktuar, e pranuar me marrëveshje, për të shprehur në mënyrë sasiore madhësi të tjera të së njëjtës natyrë.

1.6. **Mjet matës** - çfarëdo pajisje apo instrument matës, sistem me funksione matëse si dhe materialet referente.

1.7. **Tipi i mjetit matës** - seria e mjeteve matëse, me funksion identik, bazuar në të njëjtin parim, që kanë të njëjtin projekt dhe që janë prodhuar nga i njëjti prodhues, në bazë të njëjtit dokumentacion teknik dhe teknologjik.

1.8. **Etalon matjeje** - masë matjeje, mjet matës, sistem matës ose material referent i përcaktuar të realizojë, të ruajë ose të riprodhojë një njësi ose më shumë vlera të një madhësie, për t'i transmetuar ato, me anë të krahasimeve me mjete të tjera matëse.

- 1.9. **Etalon shtetëror i matjeve** - një etalon i deklaruar nga Departamenti i Metrologjisë të Kosovës dhe miratuar nga Ministri për të shërbyer në Republikën e Kosovës si bazë për përcaktimin e vlerave të etalonëve të tjera të madhësisë përkatëse.
- 1.10. **Etalon referent** - etaloni që ka cilësinë më të lartë metrologjike në një vend apo organizatë të dhënë, nga i cili rrjedhin matjet e bëra.
- 1.11. **Ruajtje e etalonit të matjes** - të gjitha veprimet e nevojshme për të ruajtur karakteristikat metrologjike të etalonit të matjes, brenda kufijve të caktuar.
- 1.12. **Material referent** - materiali ose substanca me homogjenitet të mjaftueshëm dhe të qëndrueshëm, për një apo më shumë cilësi, i përdorur në kalibrim, për përcaktimin e vlerës së një materiali tjetër ose për sigurimin e cilësisë.
- 1.13. **Material referues i certifikuar** - materiali referues, i shoqëruar me dokumentacion të lëshuar nga organi kompetent dhe konform procedurave, të përdorura për të shtuar vlera cilësore specifike me pasiguri dhe gjurmueshmëri metrologjike.
- 1.14. **Transmetueshmeri (Gjurmueshmëri)** - cilësia e rezultatit matës përmes së cilit rezultati krijon lidhje me etalonin referent zakonisht etalonit shtetëror ose ndërkombëtar nëpërmjet të zinxhirit të pa këputur të kalibrimit të dokumentuar, ku secili kontribon në pasigurinë matëse.
- 1.15. **Kalibrim** - seria e veprimeve në kushte të veçanta që përcakton marrëdhënien ndërmjet vlerave të treguara nga mjete matës ose sistemi matës dhe vlerës korresponduese të realizuar nga etaloni i matjes.
- 1.16. **Verifikimi** - konfirmimi nëpërmjet ekzaminimit dhe evidentimit nëse janë plotësuar kërkesat specifike, tekniko-metrologjike.
- 1.17. **Certifikim** - veprimtaria nga një palë e tretë e pavarur, që dëshmon zyrtarisht se një produkt, proces apo shërbim është në përputhje me kërkesat e përcaktuara në aktet nënligjore të këtij ligji ose konform standardeve të përcaktuara.
- 1.18. **Testim** - ekzaminimi i instrumentit, sistemit matës dhe përcaktimi i konformitetit të tyre me kërkesat specifike, ose mbi bazën e një vlerësimi profesional, me kërkesa të përgjithshme.
- 1.19. **Shenja e konformitetit** - shenja dalluese e cila vendoset mbi një produkt ose ambalazhin e tij, për të dëshmuar se produkti i plotëson kriteret e vendosura sipas specifikimeve teknike.
- 1.20. **Vlerësim i konformitetit** - çdo veprim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që përcakton plotësimin e tërësisë së kërkesave teknike të përcaktuara për produkte, shërbime apo procesi.
- 1.21. **Parapaketimi** - kombinimi i një produkti dhe një paketimi individual. Një produkt është i para-paketuar kur ai vendoset në paketim të çfarëdo natyre qoftë pa prezencën e konsumatorit dhe sasia e produktit që përmban në paketim ka një vlerë të paracaktuar dhe nuk mund të ndryshohet pa hapje dhe modifikim të dukshëm.
- 1.22. **Shishja, si enë matëse** - çfarëdo enë mbushëse prej qelqi ose ndonjë materiali tjetër me një fortësi dhe qëndrueshmëri jo lehtë modifikuese të projektuar për t'u taposur, që destinohet për magazinim, transport ose shpërndarje të lëngjeve e që ka karakteristika metrologjike të tilla, që mund të përdoren si shishe matëse.
- 1.23. **Matje zyrtare** - një matje të kryer nga Departamenti i Metrologjisë ose nga subjekti i autorizuar, në përputhje me vendimin për autorizim. Matja zyrtare përdoret si evidencë e besueshme në procedurat dhe vendimmarrjet e organit Qeveritar apo të Gjykatave.
- 1.24. **Miratim i tipit të instrumenteve matëse** - pranimi i instrumenteve matëse për verifikim fillestar dhe kur kjo e fundit nuk kërkohet, atëherë lëshohet autorizimi për t'i hedhur ato në treg dhe/ose për t'i vënë në përdorim.

1.25. **Lejim për hedhje në treg ose vënie në përdorim të instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara** - leja e dhënë nga Departamenti i Metrologjisë të Kosovës për hedhjen në treg ose vënien në përdorim të instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara, të cilat nuk kanë shenjën e verifikimit fillestar.

1.26. **Furnitor** – prodhuesi i produktit të regjistruar në Kosovë dhe çdo person tjetër që paraqitet si prodhues i cili vendos në produkt emrin, shenjën mbrojtëse të tij apo ndonjë shenjë tjetër dalluese ose përpunon në tërësi produktin, përfaqësuesin e prodhuesit kur prodhuesi nuk është i regjistruar në Kosovë ose kur nuk ka përfaqësues të regjistruar në Kosovë, importuesin e produktit, si dhe personat tjerë në hallkën e furnizimit, në masën në të cilën veprimtaritë e tyre mund të ndikojë në karakteristikat e sigurisë së produktit.

1.27. **Autorizim** - dhënia e të drejtës, për të kryer verifikimin dhe kalibrimin e mjetit matës në fushën e subjekteve që kryejnë veprimtari në Kosovë.

1.28. **Subjekti i autorizuar** - personi fizik dhe juridik i cili kryen detyra në fushën e metrologjisë.

1.29. **Inspektim** - mbikëqyrja metrologjike të një produkti, shërbimi, procesi ose të një sistemi matës, sipas kërkesave të caktuara ose në bazë të një gjykimi profesional.

1.30. **Laboratori Qendror i Metrologjisë së Kosovës (LQMK)** – njësi e veçantë në kuadër të DMK-së.

1.31. **Instituti i metrologjisë (IMLK)** – njësi e veçantë në kuadër të DMK-së, më lokacion në Prizren.

1.32. **Metrolog i autorizuar** – zyrtari i DMK-së apo person juridik i autorizuar, i cili i përmbush kushtet e përshkruara dhe i cili ka dhënë provimin profesional për metrolog të autorizuar.

1.33. **Komisioni për metrolog të autorizuar** – Organi i formuar nga Ekspert të instituteve profesionale në bashkëpunim me DMK-në.

1.34. **Programi i provimit profesional** – programi adekuat profesional për fushën e metrologjisë për të cilën kërkohen kushtet dhe kriteret për çertifikimin e metrologut.

2. Nëse shprehjet dhe përkufizimet nuk janë të përcaktuara në nenin 2 të këtij ligji dhe dispozita në zbatim të tij, vlejnë - përdoren termat nga fjalori ndërkombëtar i terminologjisë bazike dhe të përgjithshme të metrologjisë VIM-International Vocabulary of Metrology - Basic and general Concepts and Associated Terms in Metrology dhe VIML-International Vocabulary of Terms in Legal Metrology.

Neni 4 Organizimi, Detyrat dhe Përgjegjësitë e Departamentit të Metrologjisë

1. Departamenti i Metrologjisë është përgjegjës për zhvillim dhe mbikëqyrjen e sistemit të metrologjisë në tërë territorin e Kosovës.

1.1. departamenti i metrologjisë në kuadër të strukturës organizative përfshinë edhe LQMK dhe IMLK të cilat kanë rol të veçantë brenda departamentit të precizuara në akt nënligjor.

2. Organizimi dhe funksionimi i Departamentit të metrologjisë dhe njësive të saj rregullohet me akt nënligjor.

3. Departamenti kryen punë profesionale, administrative dhe organizative në fushën e metrologjisë, në kuptim të dispozitave të këtij ligji dhe ligjeve tjera.

4. Përveç punëve të përshkruara nga paragrafi 3 i këtij neni Departamenti ka këto detyra dhe përgjegjësi:

4.1. propozon dhe harton legjislacionin në fushën e metrologjisë;

- 4.2. bashkërendon punën me organet tjera të sistemit të metrologjisë dhe mbështet zhvillimin e këtij sistemi;
- 4.3. përgjigjet për etalonët shtetëror;
- 4.4. mban dhe ruan disa nga etalonët shtetëror të njësive të matjes në laboratorët e saj;
- 4.5. monitoron mënyrën e mbajtjes, ruajtjes dhe të përdorimit për të gjithë etalonët shtetëror të matjeve;
- 4.6. organizon aktivitetet e kalibrimit në Kosovë;
- 4.7. certifikon materialet referuese;
- 4.8. kryen kontrollin ligjor të mjeteve matëse;
- 4.9. kryen kontrollin sasior të produkteve të para paketuara dhe të shisheve, si enë matëse;
- 4.10. mban evidencën e të gjithë prodhuesve dhe furnitorëve të para paketimit dhe shisheve si enë matëse;
- 4.11. rekomandon dhënien e autorizimit subjekteve për verifikimin e mjeteve matëse, ekspertizën metrologjike, si dhe për riparimin e mjeteve matëse;
- 4.12. kryen mbikëqyrjen metrologjike;
- 4.13. kryen mbikëqyrjen e mjeteve matëse, të prodhuara në vend dhe/ose të importuara, në zbatim të dispozitave ligjore në fuqi;
- 4.14. përcakton rregullat dhe mënyrën për kualifikimin dhe trajnimin e personelit të saj dhe ofron kualifikime për çështje të metrologjisë për specialistët e tjerë të subjekteve të autorizuar;
- 4.15. bashkëpunon me institucionet e tjera, veçanërisht me ato të infrastrukturës shtetërore të cilësisë dhe institucionet e mbrojtjes së konsumatorit;
- 4.16. shërben si referencë shtetërore për sistemin shtetërore të akreditimit të laboratorëve të kalibrimit, për aftësitë dhe etalonët e matjeve;
- 4.17. bashkëpunon me organet shtetërore të metrologjisë të vendeve të tjera për arritjen e marrëveshjeve të njohjes së ndërsjellë në veprimtarinë e fushës përkatëse, rajonale apo ndërkombëtare, ose për të arritur marrëveshje dypalëshe;
- 4.18. ofron këshillime për problemet që kanë të bëjnë me metrologjinë;
- 4.19. kryen detyra tjera administrative dhe profesionale që kanë të bëjnë me metrologjinë.

Neni 5 Njësit Matëse

1. Në Republikën e Kosovës do të përdoret Sistemi Ndërkombëtar i Njësive të Matjes (SI).
2. Me akt nënligjor përcaktohet përdorimi i njësive SI dhe njësive të tjera jashtë sistemit SI, kur ato përdoren ndërkombëtarisht dhe nuk rrjedhin drejtpërdrejt nga sistemi SI.

Neni 6 Etalonët

1. Etalonët shtetëror të matjes realizohen, ruhen dhe mirëmbahen nga Departamenti, i cili siguron transmetueshmëri (gjurmueshmëri) deri te etalonët ndërkombëtare ose etalonët shtetëror të shteteve tjera.
2. Etaloni referent të cilin e posedon, ruan dhe mirëmban subjekti i autorizuar, mund të pranohet nga Departamenti si etalon shtetëror.
3. Departamenti mund të vendos që etalonët e caktuar të zhvillohen dhe mirëmbahen në institucione të tjera publike apo private.
4. Nuk është e domosdoshme që për çdo madhësi fizike të shpallet etaloni shtetëror i matjeve.
5. Mbjtësit e etalonëve shtetëror shpallen me vendim të drejtorit të departamentit.
6. Me akt nënligjor përcaktohen kushtet që duhet të plotësojë një etalon referues për t'u shpallur si etalon shtetëror i matjes, kushtet për anulimin e shpalljes dhe arsyet, mirëmbajtjen e detyrueshme dhe mënyrën e përdorimit të etalonëve shtetëror të matjeve.

Neni 7

Laboratorët e etalonëve shtetëror

1. Departamenti dhe subjektet që zhvillojnë, mirëmbajnë dhe përdorin etalonët shtetëror të matjeve, kryejnë detyrat e laboratorit të etalonëve shtetëror për madhësinë fizike përkatëse, si më poshtë:
 - 1.1. sigurimin e transmetueshmërisë (gjurmueshmërisë) së etalonëve shtetëror të matjeve me njësitë SI;
 - 1.2. përhapjen e njësive të etalonëve shtetëror të matjeve tek etalonët referuese të matjeve dhe të mjeteve matëse me anë të kalibrimit;
 - 1.3. sigurimin e njohjes ndërkombëtare të etalonëve shtetëror të matjeve dhe të certifikatës së kalibrimit të lëshuar;
 - 1.4. ndërmarrjen e masave për ruajtjen e transmetueshmërisë (gjurmueshmërisë), në rastin e dëmtimit dhe të shkatërrimit të etalonëve shtetëror të matjeve.
2. Aftësia teknike e laboratorëve të etalonëve shtetëror të matjeve ruhet nëpërmjet pjesëmarrjes në veprimtaritë metrologjike ndërkombëtare dhe vlerësohet me akreditim apo në një mënyrë tjetër të barasvlershme.
3. Departamenti bashkërendon veprimtaritë e laboratorëve të etalonëve shtetëror të matjeve drejt njohjes ndërkombëtare.
4. Laboratorët e etalonëve shtetëror duhet t'i dërgojnë Departamentit të dhëna për veprimtaritë me etalonët shtetëror të matjeve, përfshirë edhe të dhënat për përdorimin e fondeve buxhetore në bazë të kontratës së hartuar mes tyre.

Neni 8

Kalibrimi i etalonëve dhe mjeteve matëse

1. Kalibrimi i etalonëve dhe mjeteve matëse kryhet konform dokumenteve dhe rekomandimeve të organizatave ndërkombëtare për standardizimin, akreditimin dhe metrologjinë.
2. Kalibrimi i etalonëve dhe mjeteve matëse kryhet në laboratorët e kalibrimit, me kërkesën e përdoruesit.
3. Rezultatet e kalibrimit dëshmohen me certifikate kalibrimi.
4. Me akt nënligjor përcaktohen kushtet që duhet t'i përmbushin laboratorët për kalibrim.

Neni 9
Detyrat e laboratorëve të metanolëve shtetëror

1. Detyrat e laboratorëve të etalonëve shtetëror për të mbështetur transmetueshmërinë (gjurmueshmërinë) e matjeve janë:

- 1.1. të ofrojnë kalibrime të etalonëve referent të matjeve të laboratorëve të kalibrimit, bazuar ne kërkesë;
- 1.2. të sigurojnë vlerat referuese të njërive respektive të matjeve për krahasimet ndërlaboratorike, të organizuara për laboratorët e kalibrimit.

Neni 10
Certifikimi i materialeve referente

1. Certifikimi i materialeve referente është një procedurë, që vendos një apo më shumë cilësi të vlerave të një materiali ose substance, me një proces që siguron transmetueshmërinë (gjurmueshmërinë) ndaj SI-se.
2. Cilësitë e vendosura të vlerave dhe pasiguritë shoqëruese të matjeve paraqiten në certifikatë.
3. Certifikimi i materialeve referuese kryhet konform procedurave të miratuara me akt nënligjor.
4. Testimi i cilësive të materialeve referuese kryhet nga laboratorët e testimit.
5. Certifikimi i materialeve referuese kryhet nga Departamenti dhe subjektet e autorizuar për certifikim.
6. Aftësia teknike për testimit të materialeve referuese dhe subjekteve të autorizuar dëshmohet përmes veprimtarisë metrologjike.

Neni 11
Vlerësimi i Konformitetit të mjeteve matëse

1. Në Republikën e Kosovës mund të plasohen në treg dhe/ose të vihen në përdorim vetëm ato mjete matëse:
 - 1.1. të cilat i plotësojnë kërkesat nga ky ligj;
 - 1.2. kërkesat tekniko metrologjike të përshkruara me dispozita në zbatim të këtij ligji, si dhe;
 - 1.3. nëse kanë kaluar procedurat e përshkruara të vlerësimit të konformitetit.
2. Furnitori i mjetit matës ose subjekti i i autorizuar është përgjegjës për kryerjen e procedurave të vlerësimit të konformitetit dhe garanton se mjetet matëse përputhen me kërkesat metrologjike të përshkruara.
3. Mjetet matëse të cilat i plotësojnë kushtet nga paragrafi 1. i këtij neni, duhet që para se të plasohen në treg të jenë të shënuara me shenja të përshkruara të konformitetit dhe të përcillen me dokumente të konformitetit sipas dispozitave ligjore.
4. Mjetet matëse në përdorim duhet të përdoren në përputhje me kërkesat për atë lloj të mjetit matës, dokumentet e konformitetit dhe në përputhje me udhëzimet e prodhuesit të mjetit.
5. Mjetet matëse të cilat nuk plotësojnë kushtet nga paragrafi i 1. i këtij neni dhe të cilat nuk janë shënuar dhe nuk posedojnë dokumentet e konformitetit sipas kërkesave metrologjike, nuk lejohen të përdoren.

6. Me akt nënligjor përcaktohen procedurat e vlerësimit të konformitetit të mjeteve matëse.

Neni 12 Mjetet matëse ligjore

1. Mjete matëse ligjore janë mjetet të cilat përdorën për:
 - 1.1. qarkullimin e mallrave;
 - 1.2. mbrojtjen e shëndetit të njerëzve dhe shtazëve, sigurisë së përgjithshme;
 - 1.3. mbrojtjen e pasurisë, mjedisit dhe resurseve natyrore, mbrojtjen në punë, mbrojtjen e konsumatorit, mbrojtje nga fatkeqësitë, kontrollin e produkteve të para-paketuara dhe shishet si enë matëse;
 - 1.4. matjet e përcaktuara me këtë ligj, ligje tjera dhe dispozita të miratuara për implementimin e tyre.
2. Mjetet matëse ligjore duhet të tregojnë rezultate matëse në njësit matëse ligjore.
3. Me akt nënligjor përcaktohen mjetet matëse ligjore të cilat i nënshtrohen mbikëqyrjes metrologjike.

Neni 13 Përgjegjësit për mjetet matëse ligjore në përdorim

1. Përgjegjës për mjetet matëse ligjore në përdorim është shfrytëzuesi, i cili duhet:
 - 1.1. të përdorë vetëm ato mjete matëse të cilat janë të verifikuara;
 - 1.2. të mbajë mjetet matëse në gjendje teknike që këto të sigurojnë saktësi të matjes;
 - 1.3. të paraqes në verifikim mjetet matëse që janë në përdorim, në pajtim me këtë ligj dhe dispozita të miratuara në zbatim të tij;
 - 1.4. të përdorë mjetet matëse ligjore në përputhje me destinimin e tyre;
 - 1.5. të mbajë evidencë rreth mirëmbajtjes dhe verifikimit të mjeteve matëse ligjore në përdorim, kur kjo është e përcaktuar.
2. Mjeti matëse ligjor, që nuk është në përdorim, duhet të jetë i shënuar në mënyrë të dukshme, me shenjën "Mjeti matës jashtë përdorimit".

Neni 14 Verifikimi i rregullt, jo i rregullt dhe ekspertiza e mjeteve matëse

1. Të gjitha mjetet matëse në përdorim duhet të jenë të transmetueshem (gjurmueshem) deri te etalonët shtetëror, respektivisht etalonët ndërkombëtare.
2. Mjetet matëse në përdorim, duhet të plotësojnë kërkesat sipas tipit të miratuar të mjetit matës dhe/ose kërkesat e përshkruara metrologjike.
3. Me miratim të tipit të mjeteve matëse përcaktohet përdorshmeria e mjetit matës, ndërsa përmbushja e kërkesave metrologjike vërtetohet me verifikim.
4. Përgjegjës për sigurimin e verifikimit të rregullt dhe jo të rregullt të mjetit matës ligjor është vet shfrytëzuesi.

Neni 15
Verifikimi i rregullt i mjeteve matëse

1. Verifikimi i rregullt i mjeteve matëse bëhet në afate kohore të përcaktuara, për llojet e caktuara të mjeteve matëse.
2. Subjektet të cilat shesin energji termike, energji elektrike, ujë apo gaz, janë të detyruara të përkujdesen për verifikim të rregullt të mjeteve matëse të energjisë termike, matësit e gazit, korrektuesve, matësit e ujit dhe matësit e energjisë elektrike.
3. Me akt nënligjor përcaktohen mënyrat dhe afatet e verifikimit të rregullt të mjeteve matëse.

Neni 16
Verifikimi jo i rregullt i mjeteve matëse

Verifikimi jo i rregullt i mjeteve matëse bëhet në rastet kur mjete matës ligjor nuk ka qenë në përdorim për shkak të defektit apo mangësive teknike ose në rastin kur mjete nuk i është nënshtruar verifikimit të rregullt në afat kohor të paraparë.

Neni 17
Verifikimi i jashtëzakonshëm i mjeteve matëse

1. Verifikimi i jashtëzakonshëm i mjeteve matëse dhe matjet zyrtare bëhet me ekspertize metrologjike.
2. Subjektet kanë të drejtë të kërkojnë që Departamenti të kryejë një verifikim të mjetit matës ligjor në përdorim dhe matje zyrtare kur dyshohet për një funksionim jo korrekt të mjetit matës.
3. Shpenzimet që dalin gjatë testimit të mjeteve matëse dhe matjeve zyrtare mbulohen nga pala që i bëhet testimi.
4. Me akt nënligjor përcaktohet procedura e testimit të mjeteve matëse dhe matjeve zyrtare, përmbajtjen dhe afatin e ruajtjes së raportit të testimit.

Neni 18
Hapësira dhe vendi i verifikimit të mjeteve matëse

1. Departamenti ose subjekt i autorizuar kryen verifikimin e mjeteve matëse ligjore në hapësirat e veta dhe në vendet e verifikimit.
2. Vendi i verifikimit është vendi jashtë hapësirave të Departamentit ose të një subjekti të autorizuar, ku këto të fundit kryejnë verifikimin e një tipi të veçantë të mjetit matës ligjor, duke përdorur pajisjet e përshkruara.
3. Departamenti ose subjekti i autorizuar kryen verifikimin e mjetit matës ligjor në vendet ku janë vendosur, apo instaluar mjetet matës, në rastet kur mjete matës, për shkak të konstruksionit, është i lidhur me vendin e instalimit, ose në rastet kur mjetet matëse për shkak të konstruksionit të tyre, mund të dëmtohen apo thyhen gjatë transportit.
4. Kur verifikimi i mjeteve matëse ligjore kryhet sipas paragrafit 3. të këtij neni Departamenti ose subjekti i autorizuar mund t'i kërkojë parashtruesit të kërkesës numrin e duhur të personelit ndihmës dhe pajisje për verifikim.

Neni 19
Certifikata e verifikimit të mjeteve matëse

1. Departamenti ose subjekti i autorizuar është i detyruar të lëshojë certifikatën e verifikimit edhe kur mjete matës është i shënuar me shenjë verifikuese, nëse këtë e kërkon parashtruesi i kërkesës.

2. Mjetet matëse të cilat nuk kanë nevojë të verifikohen duhet të mirëmbahen rregullisht, kurse procedurat, përmbajtja dhe afati i mirëmbajtjes së rregullt përcaktohen me akt nënligjor.

Neni 20 **Vlefshmëria e verifikimit të mjeteve matëse**

1. Vlefshmëria e verifikimit të mjeteve matëse ligjore ndërpritet nëse:

1.1. ka skaduar validiteti i verifikimit;

1.2. në mjetin matës janë bërë ndryshime të cilat mund të ndikojnë në karakteristikat metrologjike të tij;

1.3. mjete matës është dëmtuar në atë mënyrë që ka mund të humbë ndonjë veti të rëndësishme që është objekt i verifikimit;

1.4. shenja e verifikimit është dëmtuar;

1.5. shihet qartë se mjete matës ka humbur vetit e nevojshme metrologjike edhe nëse shenja e verifikimit nuk është e dëmtuar;

1.6. vendi i instalimit të mjeteve matëse është ndryshuar.

Neni 21 **Shenjat shtetërore të verifikimit të mjeteve matëse**

1. Shenjat e verifikimit të cilat përdoren në Republikën e Kosovës janë shenjat shtetërore të verifikimit.

2. Me akt nënligjor përcaktohet lloji, forma dhe mënyra e vendosjes së shenjave të verifikimit të cilat përdoren në verifikimin e mjeteve matëse ligjore, si dhe forma dhe përmbajtja e certifikatës së verifikimit.

Neni 22 **Përdorimi i mjeteve matëse të riparuar**

1. Me akt nënligjor përcaktohet se:

1.1. një mjete matës ligjor i riparuar mund të përdoret brenda një periudhe shtatë (7) ditore, duke filluar nga dita që ai është riparuar ose përgatitur për verifikim;

1.2. përgjegjësini për periudhën sikurse në nën-paragrafin 1.1 të këtij paragrafi e bart subjekti autorizuar për riparim;

1.3. subjekti i autorizuar përgatit mjetin matës për verifikim, e teston dhe mbron nga ndërhyrja e paautorizuar, nëpërmjet shënimit me shenjën e verifikimit të shërbimit të autorizuar.

2. Subjekti i autorizuar për të kryer veprimtari metrologjike riparimi duhet të bëjë menjëherë një kërkesë për verifikimin e mjetit matës ligjor të riparuar, i cili është shënuar me shenjën e verifikimit të subjektit të autorizuar.

Neni 23 **Afatet kohore të kalibrimit që përdoren për verifikimin e mjeteve matëse**

1. Për verifikimin e mjeteve matëse ligjore mund të përdoren vetëm etalonët të cilët janë të kalibruar dhe kanë certifikatën valide të kalibrimit, respektivisht materialet referente të cilat janë certifikuar dhe kanë certifikatën valide.

2. Kalibrimi i etalonëve, gjegjësisht certifikimi i materialeve referente, për nevojat e verifikimit të mjeteve matëse ligjore, kryhet nga Departamenti, laborator i autorizuar për kalibrimi si dhe laborator i autorizuar për testim.

3. Me akt nënligjor përcaktohen afatet kohore të kalibrimit, për etalonët të cilët përdoren për verifikimin e mjeteve matëse ligjore.

Neni 24

Certifikatat dhe shenjat e konformitetit të lëshuara jashtë vendit

1. Departamenti mund të pranojë certifikatat dhe dokumentet e konformitetit, nëse ato janë lëshuar sipas kërkesave të Organizatës Ndërkombëtare të Metrologjisë Ligjore, si dhe sipas kërkesave të Direktivave të Bashkësisë Evropiane për fushën e metrologjisë (NAWI dhe MID).

2. Departamenti mban regjistër të certifikatave, shenjave të konformitetit, të lëshuara në përputhje me këtë nen.

Neni 25

Para-paketimet e kontrolluara ligjërisht

1. Dispozitat e këtij ligji zbatohen për para-paketimet individuale, të kombinuara, pa ambalazh mbështjellës dhe në enë matëse, që janë prodhuar, hedhur në treg ose ofruar për konsum të përgjithshëm.

2. Mostrat e lira, disa nga para-paketimet e destinuara, të përdorura në aeroplanë, anije dhe trena dhe produktet në kontejnerë, që janë përgatitur për konsumatorin e fundit, në bazë të një kontrate të ndërsjellë, nuk vlerësohen para-paketime, sipas dispozitave të këtij ligji.

3. Me akt nënligjor përcaktohen kriteret, parimet kryesore dhe masat e përgjithshme për para-paketimet; para-paketimet që kontrollohen ligjërisht; kërkesat metrologjike për sasinë neto të para-paketimeve; diapazonet e detyrueshme për sasinë nominale të disa para-paketimeve; metodat referuese për kontrollin e sasisë neto të para-paketimeve; mbishkrimet dhe shenjat e vendosura në para-paketime

Neni 26

Shishet si enë matëse për produktet e para-paketuara

1. Shishet si enë matëse përmbajnë shenjat që tregojnë vëllimin nominal dhe atë të mbushjes deri në nivelin e plotë si dhe me shenjën që identifikon prodhuesin e enës matëse.

2. Me akt nënligjor përcaktohen shishet, që kontrollohen ligjërisht, kërkesat metrologjike për shishet si enë matëse, metodat referuese për kontrollin e vëllimit neto të shisheve, mbishkrimet dhe shenjat e vendosura në shishet si enë matëse.

Neni 27

Hedhja në treg e para-paketimeve dhe e shisheve

1. Mallrat e para-paketuara dhe shishet si enë matëse, mund të hidhen në treg dhe të ofrohen për shitje, vetëm nëse plotësojnë kërkesat metrologjike të përcaktuara dhe kanë mbishkrimet dhe shenjat e përshkruara deri në kohën e blerjes.

2. Prodhuesi ose importuesi është përgjegjës për përputhshmërinë e produkteve të para-paketuara dhe të shisheve me masat e përcaktuara në këtë ligj.

3. Prodhuesi zbaton sistemin e tij të kontrollit të sasisë neto të para-paketimeve ose sistemin e kontrollit të vëllimit neto të shisheve të prodhuara.

4. Prodhuesi ose importuesi është i detyruar të njoftojë departamentin kur konstaton se para-paketimit ose shishet e hedhura në treg prej tij nuk përmbushin kërkesat teknike në mënyrë që të merren masat e duhura për mbrojtjen e konsumatorit.

Neni 28 **Regjistrimi i prodhuesve dhe i importuesve**

1. Regjistrimi i prodhuesve dhe i importuesve bëhet në bazë të kërkesës së tyre në Departament.
2. Mënyra dhe procedura përcaktohet me akt nënligjor.
3. Prodhuesit dhe importuesit detyrohen të njoftojnë Departamentin për çdo ndryshim të kryer pas regjistrimit.

Neni 29 **Miratimi dhe monitorimi i sistemit të kontrollit sasior të prodhuesve të para-paketimeve**

1. Departamenti kryen mbikëqyrjen në vend të sistemit të kontrollit sasior të prodhuesve si dhe monitoron sistemin e kontrollit sasior të miratuar në kushtet e prodhuesit dhe në qoftë se është e nevojshme jep rekomandime për përmirësimin e tij.
2. Çdo prodhues është i obliguar që të marrë miratimin e Departamentit për sistemin e kontrollit sasior.
3. Regjistrimi i prodhuesve bëhet dhe ruhet vetëm nëse sistemi i tij i kontrollit sasior është miratuar.

Neni 30 **Autorizimi**

1. Departamenti rekomandon Ministrit dhënien e autorizimit subjektiv që i plotëson kushtet e përcaktuara për të realizuar verifikimin e mjeteve matëse ligjore dhe ekspertizën metrologjike.
2. Departamenti rekomandon Ministrit dhënien e autorizimit subjektiv që i plotëson kushtet për shërbimin e riparimit të mjeteve matëse.
3. Subjekti i autorizuar i cili benë riparimin sipas paragrafit 2. të këtij neni nuk mund të kryej verifikimin e mjeteve matëse.
4. Autorizimi mund të jepet subjektiv nëse:
 - 4.1. posedon pajisje të nevojshme teknike dhe hapësirë për të kryer aktivitete për të cilat kërkohet autorizimi;
 - 4.2. ka siguruar gjurmueshmërinë e etalonëve dhe mjeteve matëse të cilat i përdorë, dhe nëse dëshmon se ka vendosur një sistem të menaxhimit në përputhje me kërkesat nga standardet e njohura ndërkombëtare;
 - 4.3. punëson persona profesionalisht të aftësuar, për kryerjen e detyrave të metrologjisë;
 - 4.4. nuk merret me prodhimin, importimin, shitjen apo riparimin e mjeteve matëse, nga fushat e autorizimit;
 - 4.5. jep garancion për kompensimin e dëmeve të shkaktuara me punën e tyre, dhe
 - 4.6. nuk është në procedurë të falimentimit.

5. Me akt nënligjor përcaktohen kushtet dhe kriteret tekniko-metrologjike për autorizimin e personave juridikë për kryerjen e veprimtarive në metrologjinë ligjore dhe për autorizimin e subjektit për kryerjen e shërbimit të riparimit të mjeteve matëse.

Neni 31 **Afati për lëshimin e autorizimit**

1. Departamenti në afat prej tridhjetë (30) ditë, nga dita e parashtrimit të kërkesës, rekomandon Ministrit lëshuarjen e autorizimit.
2. Me vendim për autorizimin, përcaktohet fusha dhe vëllimi i autorizimit.
3. Autorizimi vlen tri (3) vite.
4. Pas marrjes së vendimit për autorizim departamenti i ndanë subjektit të autorizuar shenjen e verifikimit për verifikimin e mjeteve matëse ligjore.

Neni 32 **Anulimi i vendimit**

1. Vendimi për autorizimin mund të anulohet pjesërisht apo në tërësi, nëse subjekti:
 - 1.1. nuk i përmbush kërkesat e përcaktuara me këtë ligj, dispozitat për zbatimin e tij dhe me vendimin për autorizim;
 - 1.2. nuk i kryen detyrat paraparë me ligj;
 - 1.3. tregon mangësi profesionale dhe teknike në ushtrimin e detyrave në fushën e autorizimit;
 - 1.4. me kërkesën e subjektit.
2. Subjektit të autorizuar të cilit i është anuluar vendimi, me arsyen se ai nuk ka punuar konform dispozitave, profesionalisht dhe në pajtim me autorizimin, nuk mund të parashtrorj kërkesë të re për autorizim gjatë afatit kohor trevjeçar, nga dita e anulimit të tij.

Neni 33 **Pavlefshmëria e autorizimit**

1. Autorizimi behet i pavlefshëm kur:
 - 1.1. mbaron afati i vlefshmërisë;
 - 1.2. nxirret vendimi për revokimin e autorizimit;
 - 1.3. i autorizuari heq dorë, me shkrim, nga autorizimi.

Neni 34 **Publikimi i vendimit të autorizimit**

Vendimi për autorizimin, ndryshimet dhe ndërprerjen e validitetit të autorizimit, publikohet në Veb faqe të ministrisë.

Neni 35 **Detyrimet e subjektit të autorizuar**

1. Subjekti i autorizuar duhet:

- 1.1. të kryej veprimtaritë e tij, konform dispozitave, me profesionalizëm dhe në pajtim me vendimin për autorizim;
- 1.2. të njoftoj menjëherë Departamentin për ndërprerjen apo ndryshimin e kushteve të autorizimit;
- 1.3. të udhëheqë detyrat për çështjet administrative, nga fusha për të cilën është autorizuar në pajtim me dispozitat, nëse me këtë ligj apo dispozitat për zbatimin e tij, nuk është rregulluar ndryshe;
- 1.4. në afatet e përcaktuara dhe në mënyrë të rregullt ti paraqesë departamentit të dhënat për regjistrimin e mjeteve matëse në evidencën për mjetet matëse.

2. Të paraqes ne departament informacion të domosdoshëm, brenda afatit të caktuar sipas procedurave për regjistrimin e mjeteve matëse ligjërisht të kontrolluara në regjistrin përkatës.

Neni 36
Pagesat dhe tarifat e shërbimeve

Te gjitha shërbimet e metrologjisë të përcaktuara me dispozita të këtij ligji, si dhe trajnimet e ofruara kryhen konform tarifave të miratuara nga Ministri me akt nënligjor.

Neni 37
Mbikëqyrja metrologjike

1. Departamenti kryen mbikëqyrjen metrologjike në zbatimin të ligjit, dispozitave tjera dhe akteve në fushën e metrologjisë si dhe mbikëqyrjen në punën profesionale të meteorologëve të autorizuar, dhe subjekteve të autorizuar.

2. Ministria në pajtim me nenin 3, paragrafi 1. nën-paragrafi 1.34 të këtij ligji, me akt nënligjor përcakton programin e provimit profesional në pajtim rekomandimet e eksperteve të fushës përkatëse

Neni 38
Te drejtat dhe detyrimet e inspektorit të metrologjisë dhe LQMK-së

1. Inspektorit i metrologjisë gjatë mbikëqyrjes ka te drejtë:

1.1. të hyjë dhe të i mbikëqyrë ndërtesat dhe kushtet e biznesit ku prodhohen, magazinohen ose përdoren mjetet matëse si dhe pajisjet e prodhimit dhe makinat, ndërtesat dhe kushtet e biznesit ku janë prodhuar, importuar dhe ofruar për shitje produktet e para-paketuara dhe shishet, si enë matëse.

1.2. inspektori ka të drejtë të verifikoj, mbikëqyre dokumentacionin e biznesit, për fushën metrologjike, regjistrimet dhe raportet e testimin të subjektit të autorizuar, ose të metrologut të autorizuar, për të parë se si janë kryer këto veprimtari.

1.3. subjektet veprimtaritë e të cilave janë objekt i mbikëqyrjes metrologjike, janë të detyruar ta ndihmojnë inspektorin për të kryer mbikëqyrjen dhe t'i japin atij të dhënat dhe informacionet e domosdoshme. Po ashtu me kërkesë me shkrim të inspektorit subjektet e autorizuar që mbikëqyren janë të detyruar të japin ose të përgatisin brenda një periudhe të caktuar me procesverbal të dhëna të plotë dhe të sakta, informacione dhe regjistrime të nevojshme për kryerjen e mbikëqyrjes

2. Gjatë mbikëqyrjes, inspektori mund të marrë dëshmi nga përfaqësuesit e subjekteve dhe dëshmitarët.

3. Për mbikëqyrjen e kryer, inspektori mban procesverbal, ku pasqyrohen të dhënat e marra. Ky procesverbal mbahet në dy kopje, njëra prej të cilave i dorëzohet subjektit të mbikëqyrur.

4. Detyrat dhe përgjegjësitë e LQMK-së do të përcaktohen me akt nënligjor.

Neni 39 **Detyrat e inspektorit të metrologjisë**

1. Gjatë mbikëqyrjes inspektori ka për detyre të verifikojë:

- 1.1. ligjshmërinë dhe kushtet në kryerjen e veprimtarive metrologjike;
- 1.2. përdorimin e njësive ligjore të matjeve;
- 1.3. ligjshmërinë dhe autoritetin ligjor në kryerjen e certifikimit të mjeteve matëse, ekzaminimin e tipit të instrumenteve matëse dhe verifikimin e mjeteve matëse ligjore;
- 1.4. përdorimin e mjeteve matëse ligjore;
- 1.5. konformitetin e para-paketimeve dhe shisheve si enë matëse me masat e këtij ligji dhe me aktet nënligjore në zbatim të tij;
- 1.6. ligjshmërinë dhe aftësinë në punë të subjekteve të autorizuar për zbatimin e dispozitave të këtij ligji;
- 1.7. mënyrën se si mbahen dhe përdoren regjistrimet dhe dokumentet e përshkruara;

2. Në rastet kur inspektori vëren shkelje të këtij ligji dhe të dispozitave në zbatim të tij atëherë:

- 2.1. urdhëron me procesverbal korigjimin e parregullsive dhe të mangësive të vërejtura brenda një periudhe kohore deri në shtatë (7) dite;
- 2.2. pezullon përdorimin e mjeteve matëse ligjore dhe pasimin në treg të paketimeve, që nuk përputhen me kërkesat e përcaktuara;
- 2.3. pezullon kryerjen e veprimtarive që janë në kundërshtim me ligjin apo me dispozitat e zbatuara;
- 2.4. pezullon punën e një subjekti të autorizuar dhe fillon procedurën për refuzimin, revokimin e autorizimit, kur ky nuk plotëson kërkesat metrologjike të përcaktuara;
- 2.5. pezullon punën e një subjekti të autorizuar apo të një meteorologu të autorizuar dhe fillon procedurën për revokimin e autorizimit, kur këta kryejnë veprimtari, për të cilat janë autorizuar, në një mënyrë joprofesionale dhe joligjore;
- 2.6. për të gjitha shkeljet e konstatuara vendos gjoba në përputhje me nenin 45 të këtij ligji.

Neni 40 **Mbështetja e inspektorit gjatë mbikëqyrjes**

1. Subjektet që i nënshtrohen mbikëqyrjes metrologjike, janë të detyruar të mbështesin inspektorin në kryerjen e mbikëqyrjes në përputhje me dispozitat e përcaktuara në nenin 35 të këtij ligji dhe të sigurojnë të gjitha kushtet për mbarëvajtjen normale të mbikëqyrjes.

2. Vlerësohet se subjekti i mbikëqyrur nuk e ka mbështetur inspektorin gjatë mbikëqyrjes të mjeteve matëse ose produkteve të paketuara sipas paragrafit 1. të këtij neni si dhe regjistrat e kërkuar të biznesit dhe dokumente të tjera të nevojshme për të marrë e mbledhur fakte.

3. Subjektet janë të detyruar që, me kërkesë të inspektorit, të ndërpresin përkohësisht veprimtarinë, nëse nuk ka rrugë tjetër për kryerjen e mbikëqyrjes.

4. Inspektori gjithnjë duhet të këtë parasysh se në rast të ndërprerjes së përkohshme sikurse në paragrafin 3. të këtij neni mos të shkaktoj dëme subjektit të mbikëqyrur.

5. Pas mbarimit të mbikëqyrjes, inspektori mund të kërkojë që subjekti i mbikëqyrur të kryej disa veprimtari që të vendosen plotësisht faktet duke përcaktuar me procesverbal afatin kohor, gjatë të cilit duhet të kryhet kjo veprimtari.

Neni 41

Detyrimet për ruajtjen e sekretit

1. Me rastin e kryerjes së mbikëqyrjes, inspektori i metrologjisë është i detyruar të veproj ashtu që të mos rrezikoj sekretin profesional të subjektit të mbikëqyrur për faktet, informacionet dhe të dhënat tjera.

2. Subjekti i mbikëqyrur është i detyruar ta njoftojnë inspektorin e metrologjisë se çka konsiderohet sekret sipas akteve të tyre të përgjithshme.

3. Inspektori nëse nuk ruan sekretin mban përgjegjësi, sipas dispozitave ligjore.

Neni 42

Vendimi për ndalimin e hedhjes në treg apo heqjes nga tregu

1. Nëse parregullsitë e konstatuara si rezultat i mosplotësimit të kërkesave konform nenit 26 dhe 27 të këtij ligji nuk janë korrigjuar brenda afatit të caktuar, para hedhjes në treg të para paketimeve, atëherë inspektori i metrologjisë, nxjerrë vendim për ndalimin e hedhjes në treg të para paketimeve.

2. Nëse parregullsitë e vërejtura konform nenit 26 dhe 27 të këtij ligji në mjetet matëse ligjore që janë në treg ose në përdorim, nuk janë korrigjuar brenda afatit të caktuar kohor me procesverbal, atëherë inspektori i metrologjisë nxjerr vendim për bllokimin, largimin nga tregu ose ndalimin e përdorimit të mjeteve matëse ligjore.

Neni 43

Detyrimi për të informuar organet kompetente

Nëse gjatë mbikëqyrjes vërehen shkelje, për të cilat me ligj përgjigjen organe të tjera të administratës shtetërore, atëherë inspektori njofton organin përkatës.

Neni 44

Ankesa

1. Kundër vendimit të inspektorit të metrologjisë pala mund të parashtroj ankesë në afat prej tetë (8) ditësh nga dita e pranimit të vendimit.

2. Drejtori është i detyruar që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e paraqitjes së ankesës të vendos për ankesën e ushtruar kundër vendimit të Inspektorit të metrologjisë.

3. Kundër vendimit të Drejtorit pala në afat prej dhjetë (10) ditësh mund të shtroj ankese të shkallës së dytë pran Komisionit profesional për ankesa, që formohet me vendim të Sekretarit të MTI-së, i cili është vendim i plotfuqishëm.

4. Kundër vendimit të Komisionit profesional për ankesa mund të parashtrohet padi në Gjykatën kompetente në afat prej tridhjetë (30) ditësh.

Neni 45

Dispozitat ndëshkuese

1. Inspektori i metrologjisë për shkeljet e konstatuara me këtë ligj shqipton këto gjopa:

2. Me gjobe prej pesëqind (500) deri njëmijepesëqind (1.500) Euro, ndëshkohet subjekti, ndërsa me gjobë prej dyqindepesëdhjetë (250) deri shtatëqindepesëdhjetë (750) Euro personi përgjegjës i subjektit në rastet si vijon:

2.1. për përdorimin e njësive matëse në kundërshtim me rregullat e përcaktuara ne baze te dispozitave te këtij ligji dhe dispozitave nga akti nënligjor qe rregullon përdorimin e njësive matëse, sipas nenit 5 te këtij ligji;

2.2. mbajtjen në biznesin e vet të një mjeti matës që nuk është në përdorim dhe nuk është shënuar në mënyrë të dukshme me shenjën “Mjeti matës jashtë përdorimit” sipas nenit 13 paragrafi 2. të këtij ligji;

2.3. mossigurimin e verifikimit periodik të mjeteve matëse në intervalet e përshkruara sipas nenit 13 paragrafi 1. nën-paragrafi 1.5. të këtij ligji;

2.4. mosvënien në dispozicion te mjeteve matëse pas riparimit për verifikim periodik, sipas nenit 22 paragrafit 1. të këtij ligji;

2.5. mosplotësimin e kërkesave për regjistrim, të përcaktuara në nenin 28 të këtij ligji.

3. Me gjobe prej njëmijë (1.000) deri tremijë (3.000), ndëshkohet subjekti i autorizua ndërsa me gjobë prej pesëqind (500) deri njëmijepesëqind (1.500) Euro personi përgjegjës i subjektit në rastet si vijon:

3.1. për mosmirëmbajtjen e rregullt te instrumenteve matëse, sipas nenit 19 paragrafin 2. te këtij ligji;

3.2. prodhimit, importimit dhe hedhjes në treg te produkteve të paketuara dhe shisheve, si enë matëse, që nuk plotësojnë kërkesat metrologjike dhe nuk kanë mbishkrimet dhe shenjat e përcaktuara, sipas nenit 27 paragrafit 4. të këtij ligji;

3.3. veprimi në kundërshtim me dispozitat e përcaktuara në nenet 32 paragrafi 2. dhe nenin 35 paragrafi 1. të këtij ligji.

4. Me gjobe prej njëmijepesëqind (1.500) deri pesëmijë (5.000) Euro, ndëshkohet subjekti ndërsa me gjobë prej pesëqind (500) deri njëmijepesëqind (1.500) Euro personi përgjegjës i subjektit ne rastet si vijon:

4.1. hedhja në treg dhe vënia në përdorim e instrumenteve matëse në kundërshtim me dispozitat e përcaktuara sipas nenit 27 paragrafin 1. të këtij ligji;

4.2. përdorimi i mjeteve matëse ligjore në kundërshtim me dispozitat e përcaktuara sipas nenit 12 paragrafin 1. nën-paragrafi 1.1., 1.2. dhe 1.3. të këtij ligji;

4.3. veprimi në kundërshtim me dispozitat e përcaktuara sipas nenit 11 paragrafi 1. te këtij ligji;

4.4. mosdhënia e informacionit dhe e të dhënave të domosdoshme inspektorit te metrologjisë për të kryer mbikëqyrjen në kundërshtim me dispozitat e nenit 38 paragrafi 1. nën-paragrafi 1.3. të këtij ligji.

Neni 46 Dispozitat kalimtare

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë për zbatim te këtij ligji detyrohet të nxjerr akte nënligjore në përputhshmëri me ligjin brenda gjashtë (6) muajsh nga data e hyrjes ne fuqi te këtij ligji.

Neni 47
Dispozitat shfuqizuese

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohet Ligji Nr.02/L-34 “Për Metrologji”, Ligji Nr. 2004/11 “Për Njësit Matëse” si dhe aktet tjera që janë në kundërshtim më këtë ligj.

Neni 48
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 03/ L-203
28 tetor 2010

Shpallur me dekreten Nr. DL-074-2010, datë 09.11.2010 nga u.d. Presidenti i Republikës së Kosovës, Dr. Jakup Krasniqi